

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SAJUS" Shpk

Ortakët themelues:

Kavaje 04.04.2023

1. Andrei Ivan Samal lindur ne Bjellorusi dhe banues ne Durres NR. ID 3300770B086PB7

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar), sot më datë 22.03.2023 harton këtë Akt Themelimi të shoqërisë tregtare si më poshtë vijon;

NENI 1

Emri

1.1 Shoqëria tregtare mban emrin "Sajus" shpk

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Ortakëve të Shoqërisë.

NENI 2

Forma

2.1 Shoqëria tregtare "Sajus" shpk, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qendrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Sajus" shpk do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën: Kavaje, Lagjia nr.3, rruga Skuraj objekt 4 katesh, kati i pare, zona kadastrale nr. 8552, pasuria nr.4/203.

NENI 4

Objekti i Veprimtarisë

4.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ne tregetimin, shitjen-blerjen e pasurive te paluajtshme.

NENI 5

Kohëzgjatja



5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë "Sajus" do të jetë me afat të pacaktuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

6.1 Shoqëria tregtare "Sajus" shpk mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

7.1 Ortakët nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë "Sajus" Shpk dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Sajus" Shpk është 100.000 (një qindemije) lekë.

Ortakët e shoqërisë janë:

- 1- **Z. Andrei Samal** është zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 100 % të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e Shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

NENI 10

Administratori

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Ortakë e Shoqërisë. Afati i emërimit është 5(Pese)vjet. Kompetencat e adminsitrorit përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është **Z.Andrei Samal** lindur ne Bjellorusi dhe Banues ne Durres, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i pasaportës me numër MC2678940.

Ky Akt Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore.

Akti ju perkthye shtetasit Andrei ne gjuhen angleze per te cilen me deklaroi se e kuptoi plotesisht nga shtetasi **ANTON KRYEZIU** lindur me date 06.11.1975, identifikuar me karte identiteti te shtetit te Serbise me nr.personal 009945921, i cili me deklaroi se ia perktheu identik aktin e mesiperm nga gjuha shqipe ne ate angleze dhe nenshkruan ne akt per te konfirmuar sa me siper.

ORTAKËT

E SHOQERISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

Sajus Shpk

Andrei Samal

Andrei Samal
[Signature]

Perktheu: **ANTON KRYEZIU**

[Signature]